

Jusuf ZIMERI

**EMANCIPIMI
I FEMRËS :
DHE MODA**

Shkup, 2003

Jusuf Zimeri

EMANCIPIMI I FEMRËS DHE MODA

Titulli:

Emancipimi i femrës dhe moda

Autor:

Jusuf Zimeri

Recensent:

Mr. Taxhudin Bislimi

Redaktor:

Prof. Shabi Sinani

Lektor & Korrektor:

Mr. Ismet Osmani

Boton:

Shoqata Ulemave - Shkup.

Jusuf Zimeri

**EMANCIPIMI I FEMRËS
DHE MODA**

Shkup, 2002

Allahu xh.sh. thotë:

*Kush bënë vepra të mira, qoftë mashkull ose
femër duke qenë besimtar, Ne do ta shpërblejmë
atë me jetë më të mirë:*

Kur'an, 16:97

*Gratë janë amanet hyjnor mes nesh dhe
për këtë respektoni ato" (Muhamedi a.s.)*

H Y R J E

Bismilahirrahmanirrahim

Falenderimi dhe lavdrimi i takon vetëm Allahut xh.sh. i cili na krijoi në formën dhe konstruktin më të mirë dhe na pajisi me të menduarit dhe dituri, kurse salavatet dhe bekimi mbi shpirtin e Muhamedit Mustafasë s.a.v.s i dli ishte mëshirë për të gjitha botrat...

Shpeshëherë në shoqërinë tonë problematizohet dhe shtjellohet tema rreth të drejtës së femrës. Ky shtjellim dita ditës po merr përmasa më të gjëra, e ndonjëherë edhe hapa të pakontrolluar. Është realitet i pakontestuar se sot në fillim të mileniumit të tretë bota bashkëkohore ballafaqohet me problemin më serioz, me çrregullimin e familjes, problem ky që i kanoset qenies njerzore. Sot gjithnjë e më shumë dëgjojmë, lexojmë përmes medimeve elektronike dhe shtypit për probleme të shumta familjare, sië janë, mosharmonia bashkëshortore, e cilat shpeshëherë përfundon edhe me tradhëti bashkëshortore, shkorporëzim, etj. Në të shumtën e rasteve viktimë e drejtëpërdrejt e tërë kësaj krahure të krijuar familjare janë femrat dhe fëmijët.

Me këtë rast, duhet theksuar se pasojat e këtyre anomalive sociale janë rezultat të disa faktorëve, përkatësisht lirisë së pakufizuar dhe të pakontrolluar të shoqërisë. Dukuri tjetër që brengosë është çveshja e qenies njeri nga petku i devotshmërisë dhe idealit shpirtërorë, që çon ate pas epsheve, pasioneve dhe materializimit të të tij plotë. Pasojat janë të dukshme ngase njeriu ka filluar të anashkaloj, të harroj se është qenie dualiste, dhe në asnjë mënyrë nuk guxon të lë pas dore njërën prej dy komponenteve përbërëse të tij. Gabimi edhe më fatal, pikërisht atëherë kur njeriu heton gabimin e tij por nuk pendohet. Ai vazhdon edhe më tutje duke ia hudhur fajin kohës dhe, duke harruar se koha asnjëherë nuk ka qenë e as që do të jetë ndonjëherë fajtorë për devijimin e njeriut.

Njeriu është i krijuar që të jetojë, logjikoj dhe veproj, e njëkohësisht përmes tyre të adhuroj Krijuesin e tij. Gjatë kësaj periudhe, s'ka dyshim se do të ballafaqohet me probleme të ndryshme jetësore, për të cilat zgjidhje më e mirë është logjika e shëndoshë, aktivitetet konkrete destinuar për këtë qëllim dhe piedestali më i lartë njerzorë- durimi. Kjo, zatën është dhe karakteristikë që e dallon njeriun nga qeniet tjera. Shpeshëherë vërejmë se njeriu për të zgjidhur problemet e natyrës ekzistenciale nuk përdorë logjikën, por vepron në kundërshtim me parimet etike duke u dhënë pas epsheve dhe sjelljeve të tij tekanjoze që dëmtojnë personalitetin e tij duke e futur ate në humnerë.

Çdo problem në jetë zgjidhet duke u futur në vetë problemin, në mënyrë të qetë, me logjikë të shëndoshë dhe bindje të fuqishme për të ngadhnjyer. Për fat të keq, njeriu sot, i dhënë pas dëfrimeve të tij gjoja për të harruar bringën që e ka kapluar gjen shpëtim në një dukuri jashtzakonisht të shëmtuar në konsumimin e alkoolit, mjeteve narkotike, prostitucionit që pothuajse i ka bërë traditë.

Ndërsa, sot bota bashkëkohore më së shumti merret me problemin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Prandaj, pikërisht për këtë kudo në botë janë formuar organizata, institucione bile edhe tribunale që merren me këtë çështje, por realisht pa zgjidhur asgjë.

Vallë pse ndodhë kjo?

Përgjigjen duhet gjetur në oratorinë e kamufluar për të drejtat e njeriut, që në esencë nuk është asgjë e sinqertë, por vetëm një sjellje letargjike e njerëzve pa përgjegjësi. Një retorikë e këthillë e eksploatuar në opinion për gjoja emancipim përkatësisht liritë dhe të drejtat e femrës, lë të kuptosh se është një problem i rëndësishëm shoqërorë, por deri më tani me ose pa dëshirë i pazgjidhur. Akoma nuk është sqaruar se ç'nënkupton dhe ç'dëshiron dikush të arrij me nocionin emancipim. Ndërkaq në trevat tona aq shumë manipulohet me këtë nocion sa që është bërë i pakuptueshëm dhe i pakuptimtë.

Këto pra ishin disa faktorë që më nxitën që në vazhdim në pika shumë të shkurta të shtjellojmë çështjen dhe realitetin e emancipimit.

EMANCIPIMI

“Fëmija i një gruaje të edukuar e të mësuar në vend se të dëgjoj përralla kundër logjikës që ta prish moralin, mbi gogolin dhe kuqëdrën, bashkë me nina-nanat e ëmbla të së ëmës do të dëgjoj përralla shumë të bukura që do t’i ndreqin moralin, që do t’i zbusin zemrën dhe do t’i zhvillojnë mendjen”

(Sami Frashëri)

Para se të fillojmë të flasim për emancipimin në përgjithësi, e në veçanti për emancipimin e femrës, patjetër duhet definuar kuptimin e këtij termi, në mënyrë që të dimë se për ç’farë bëhet fjalë.

Nocioni “emancipim” rrjedh nga fjala latine “Emancipatia” që don të thotë:

- çlirim nga varfëria,
- dalje nga tutorizmi,
- të vënit në pozita të barabarta,

- flakje e paragjytimeve dhe e besimeve të kota.¹

Në aspektin juridik me nocionin "Emancipim" nënkuptohet; shpallja e dikujt për madhor (të moshës madhore) dhe nxjerrje nga tutorizmi i prindit.²

Nëse u bëjmë një vështrim të hollësishëm etapave të zhvillimit shoqërorë nga aspekti juridik, fare lehtë nënkuptojmë se ky nocion zë fill nga e drejta romake. Në të drejtën romake i ati fëmijës bartte përgjegjësinë dhe, me plotë kuptimin e fjalës ishte tutor i fëmijës së mitur. Kur ai dëshironte të çliroj fëmijën e tij nga tutorizmi, sipas ligjit romak ishte i detyruar që të drejtën e vendosjes t'ia shesë tri herë dikuj tjetër, fqit apo mikut, e pas shitjes së tretë fëmiju konsiderohej i emancipuar, do të thotë i lirë nga tutorizmi. Ky akt i quajtur mancipim bëhej në praninë e pesë dëshmitarëve dhe të gjykatësit.

Kurse sipas të drejtës së Justinianit, ky akt u pranua si i till, por i reduktuar në formën e saj, ngase ky akt kryhej vetëm me një deklaratë gojore që bëhej nga magjistrati apo gjykata në praninë e prindit. Për këtë rast, nuk merrej parasysh mosha e djalit, por sipas kësaj të drejte, i emancipuari humbte të drejtat familjare, duke përfshirë këtu edhe të drejtën

¹ *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të huaja, Rilindja, Prishtinë 1986, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Rilindja, Prishtinë 1981, Pravna enciklopedia, Beograd 1980.*

² *Po aty,*

trashëgimore gjë e cila konsiderohej si sanksion ndaj tij.³

Në të drejtën bashkëkohore, emancipim konsiderohet akti kur një i mitur bënë lidhjen e kontratës së Martesës me një femër, por me leje të gjyqit. Ky person konsiderohet i aftë për punë dhe përgjegjës për veprimtarinë e tij në aspektin juridik dhe plotësisht është i liruar nga tutorizmi.

Nëse marrim parasysh këtë që u tha, si dhe faktin se nocioni emancipim ka prejardhje latine, pastaj rrethanat që ekzistonin në atë kohë, pozitën juridike të shoqërisë konstatohet se ky nocion është përdorur në rrethana, raste dhe akte të veçanta. Andaj me apo pa vetëdije ky nocion sot keqpërdoret kur i jepet konotacion krejtësisht tjetër nga ai që duhet të ketë.

³ *Po aty.*

TRAJTIMI I FEMRES NEPER SHEKUJ DHE SHOQERI

Njeriu nga vet natyra e tij është qenie sociale, andaj gjithmonë ka bërë përpjekje të jetoj në shoqëri të organizuar. Nga kjo nënkuptohet se për çdo kohë dhe shoqëri ekzistonin sisteme sipas së cilëve njerëzit mbështetnin besimin e tyre, të menduarit dhe veprimtarine e tyre. Ndërkaq ekziston një realitet tjetër i pakontestuar, se në të kaluarën e lashtë shumë popuj ngritjen e sistemit të tyre e mbështetnin në mitologji dhe iluzione të ndryshme. Mitologjia dhe bestytënitë e ndryshme, popujve u shërbenin për t'u ndihmuar në shtjellimin dhe komentimin e sendeve që e rrethonin njeriun. U shërbenin njerëzve për t'u dhënë udhëzime rreth ligjeve të Zotit.

Komentimet mitologjike që i bënin popujt e ndryshëm ndikuan që njerëzit të përfitojnë ide, mendime dhe besime të gabuara dhe të dëmshme, jo vetëm për individin, por për tërë shoqërinë njerzore. Këto ide, bindje të gabuara, lanë gjurmë të thella me ç'rast ndikuan në ngecjen e shoqërisë njerëzore, por në të shumtën e rasteve sakrificë direkte e këtyre devijimeve ishte gjinia femrore.

Sipas mitologjive të ndryshme u formua bindja se femra nuk mund të jetë në një shkallë të barabartë me mashkullin. Jo vetëm kaq, por ajo konsiderohej edhe përgjegjëse e drejtëpërdrejt për të gjitha të ligat që shkaktoheshin në tokë, andaj pikërisht për këtë nuk mund të flitet për kurrëfarë të drejte të saj, sepse vetvetiu është e sanksionuar.

Sipas mitologjisë greke, e cila ndikoi shumë edhe te popujt tjerë evropian, sa i përket femrës thuhet: Zoti Prometheus kishte vjedhur zjarrin nga qielli dhe ua kishte dhënë banorëve të tokës. Ky veprim e hidhëroi pa masë zotin e madh Zeusin, dhe ai vendosi të krijojë një femër të cilën e pagëzoi PANDORA, me qëllim që banorëve të tokës t'ua ndaloj begatitë e tyre.

Kjo femër gjithënjë sipas mitologjisë greke zbriti në një trevë që e sundonte Epimetheusi. Ajo me bukurinë e saj mahniti mbretin dhe ai vendosi të kurorëzohet me te. Kjo grua posedonte një kuti në të cilën ishte e grumbulluar e keqja. Një ditë e hapi ate, dhe e keqja u shpërnda në rruzullin tokësorë, andaj femra ngeli përgjegjëse për të gjitha të këqijat që ndodhin në rruzullin tokësor.

Ngjashëm është edhe mitologjia jehude rreth krijimit të Ademit a.s. dhe Havës, sepse sipas tyre Hava ishte ajo e cila bëri krimin e parë dhe vazhdon të jetë përgjegjëse. Pastaj sipas mitologjisë së egjiptasëve të vjetër Nili nuk do të rrjedhte po të mos i therrej për çdo vit nga një femër kurban. Këtë besim të viktimizimit të njeriut me urdhër të Omer b. Hatabit e zhduki Amr. B.

Asi kur e çliroi Egjiptin. Pastaj kemi mitologjinë hinduse, kineze rreth nxënies së diellit dhe të hënës, etj.

Në bazë të këtyre mitologjive dhe iluzioneve të ndryshme, të cilat kanë shërbyer si bazament për sistemin e normave juridike, të cilat norma do të kishin rregulluar raportet dhe ligjet ndërnjerzore e pastaj do të definoreshin edhe të drejtat dhe detyrimet e çdo individit, me çrast do të vemë në spikamë disa të dhëna të trajtimit të femrës nëpër disa shoqëri të njohura që në njëfar mënyre kanë lënë pasojë për shoqërinë njerzore si psh. Te hindusit, grekët e lashtë etj.

Trajtimi i femrës te Hindusit.

Sipas librave të shenjta të mitologjisë hinduse femra është symbol i së keqes, e ligë e mashkullit dhe burim i ndytësisë. Natyra e saj është që ajo të dëmtoj meshkujt, andaj nuk meriton kurrëfarë të drejte.⁴ Në këtë mënyrë pozita e saj ishte në nivel aq të ulët sa që ferri, helmi dhe zjarri ishin gjëra më të çmuara se sa femra. Karakteristikë specifike e hindusve ishte se pas vdekjes së bashkëshortit, gruaja akuzohej prej shoqërisë për vdekjen e bashkëshortit dhe denohej me vdekje apo digjej e gjallë.⁵

⁴ Dr. Sahmerani Es'ad, *El Mer'etu fit-tarihi vesh-sheriat*, f. 26

⁵ Grup autorësh, *I. Abazi etj, E drejta familjare në Islam*, f.30, Shkup 1996.

Trajtimi i femrës te grekët e vjetër.

Sipas grekëve të vjetër, femra jo që nuk kishte kurrëfarë të drejte, por konsiderohej si e ndytë dhe vepër e djallit të mallkuar. Ajo, sipas tyre ishte e dëbuar nga mëshira e perëndisë. Nuk kishte të drejtë pronësi e as trashëgimie, as nga prindi, vëllai e as nga bashkëshorti i saj⁶. Vet Aristoteli femrën dhe robërit i ka trajtuar vetëm si mjete të domosdoshme të burrit. Në uljen e personalitetit të femrës greke kanë shkuar aq larg, saqë kanë spekuluar idenë se femra edhe dhëmbë ka më pak se mashkulli. i befasuar nga një konstatim i këtill shkenctari Bertrand Russel do të shkruaj: Aristoteli mendonte se numri i dhëmbëve të femrës është më i vogël se numri i dhëmbëve të mashkujve. Ai ishte martuar dy herë, por për çudi nuk i kishte shkuar mendja që të kontrolloj gojën e saj dhe të bindej për atë që e thonte.⁷

Trajtimi i femrës te Romakët.

Romakët femrën e konsideruan vetëm si pasuri të meshkujve, dhe për këtë arsye romakët kishin të drejtë që me të të bënin tregëti sikur me çdo artikull tjetër. Të drejtat e saja ishin aq të kufizuara saqë ajo nuk kishte

⁶ *Po aty*, f.30

⁷ *Vahidudin Han, El mer'etu bejnesh-sheriatil islamijeti ve hadaretil garbij-jeti*, f. 54, Kairo 1994

të drejtë sa që qeshë, e të mos flasim për paraqitjen e mendimeve apo veshjes së rrobeve të bukura.⁸

Trajtimi i femrës te arabët para ardhejs së Islamit

Arabët para shpalljes së Kur'anit bënë dallime të mëdha midis gjinive, saqë gruaja trajtohej si një mall pa të zotin. Lindja e vajzës tek arabët konsiderohej turp dhe varfëri dhe për këtë arsye nëse lindte vajzë, prindi i saj ishte i detyruar të zgjedhë njërën prej dy alternativave; të kujdeset për fëmijën e posalindur vajzë e të jetoj me turp, ose ta varros të gjallë në mënyrë më mizore.⁹

Trajtimi i femrës në Evropë.

Ndikimi i madh i ligjeve romake dhe krishtere nënkuptonë se edhe në Evropë dhe shtetet tjera, që sot konsiderohen të përparuara, trajtimi i femrës i gërshetuar midis këture dy kulturave prapëseprapë nuk ishte në nivelin e duhur. Në Evropën krishtere femra thjesht konsiderohej vetëm si shërbëtore e meshkujve.

Kjo vërtetohet me faktin se ligjet angleze deri në vitin 1805 lejuan edhe shitblerjen e femrës. Megjithatë, është interesant të theksohet se parlamenti anglez gajtë sundimit të mbretit Henri i tretë kishte miratuar një

⁸ Grup autorësh, I. Abazi etj, *E drejta familjare në Islam*, f. 30 Shkup 1996.

⁹ Po aty, f. 31

vendim, me të cilin, femrës i ndalohej leximi i dhjatës së re, përkatësisht librave të shenjtë.¹⁰

Sipas ligjit të Napoleonit, i hartuar pas revolucionit frances në vitin 1804, në nenin 117 thuhet: Femra e martuar e cila ndodhë të ketë pasuri, nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë ta dhuroj, ta bartë ose të huazoj pasurinë e saj pa prezencën e bashkëshortit në rastin e kontratës, apo pa pëlqimin paraprak me shkrim nga bashkëshorti. Sipas këtij ligji femra nuk kishte të drejtë dëshmie e as nënshkrimi të kurrëfarë kontrate, nuk kishte të drejtë të ushtroj ndonjë mjeshtri ose të marrë ndonjë vërtetim (diplomë) pa pëlqimin e burrit. Nëse punonte, paga e saj konsiderohej pronë e burrit të saj. Ky legjislacion mbeti në fuqi deri në vitin 1938.¹¹

Në vitin 1861 një femër në Francë ka tentuar t'i nënshtrohet provimit të shkollës së mesme, një gjë e tillë nuk i është lejuar, por me intervenimin e bashkëshortes së Napoleonit asaj i është mundësuar të hyjë në provim.

Dyert e para të Universitetit në Evropë për herë të parë për gjininë femrore u hapën në vitin 1840 në Angli, kurse në Francë në vitin 1875, ku një femër kishte marrë diplomën e mjekësisë, por ligji që i lejoi femrës të ushtroj mjekësinë u miratua në vitin 1892.¹²

¹⁰ Dr. Sahmerani Es'ad, *El mer'etu fit-tarih vesh-sheria*, f. 62, *darul fikr*, Bejrut 1998, nga Muhamed Reshid Rida, *Hukukun-nisai fil islam*, f.62-63.

¹¹ *Po aty*, f. 61

¹² *Po aty*, f.62

LEVIZJA PER EMANCIPIMIN E FEMRES

Padrejtësitë dhe diskriminimet që ushtroheshin ndaj gjinisë femrore në forma të ndryshme motivizuan femrën që ajo të vëhet në lëvizje për emancipimin e saj, përkatësisht për fitimin e të drejtave të saja elementare që ia kishte dhuruar Allahu xh.sh., e që sot quhen të drejta natyrore.

Me renesansën në Evropë, dalëngadalë bota perëndimore filloi t'i ndërroj pikëpamjet dhe mendimet e saj rreth trajtimit të femrës, dhe të lirohet nga parimet krishtere të asaj kohe. Në këtë kohë filloi edhe një revolucion i madh i ndërtimit të jetës kulturore dhe ekonomike në shoqërinë kapitaliste. Në këto rrethana të paqarta lindi ideja për lëvizjen për emancipimin e femrës. Kjo lëvizje për herë të parë doli në skenë nga fundi i shekullit XVIII në Angli, e më vonë edhe në Amerikë e gjetkë. Vrullin më të madh e mori në shekullin XX duke u shtrirë në tërë rruzullin tokësor.

Për nxjerrjen në skenë të kësaj lëvizje pati ndikim edhe revolucioni i prodhimit ekonomik kapitalist i cili kërkonte fuqi punëtore dhe shfrytëzonte rastin duke manipuluar me gjoja të drejtat e femrës për barazi të

plotë me burrin ose për t'i nxjerrë ato nga burgu shtëpiak siç e quanin ata, apeluan në emancipimin e saj, por realiteti ishte diç tjetër, sigurimi i krahut të punës, përkatësisht shfrytëzimi i femrës si fuqi punëtore më e lirë. Kështu, femra në vend që ta rishqyrtoj pozitën e saj në shoqëri dhe të zë pozitën e merituar, ajo u bë object manipulimi, sepse doemos duhej të veproj kundër natyrshmërisë së krijimit të saj. Edhe kjo lëvizje parimet e saj nuk i mbështeti në baza racionale dhe natyro-shkencore, por si duket përsëri vloi në bazë të euforisë që kishte me ç'rast u harrua realiteti se problemet në asnjë shoqëri dhe në asnjë kohë nuk janë zgjidhur në mënyrë euforike, por vetëm në baza shkencore dhe racionale.

Mori Aslstonekroft është i pari i cili në vitin 1792 do të vë në spikamë barabarsinë midis gjinive në të gjitha sferat e jetës duke filluar nga arsimi, punësimi, politika etj. dhe zbatimin e vlerave të barabarta.

Sipas ideologjive për emancipimin e femrës për barazi të plotë mes gjinive është konstatuar se ndasitë që ekzistonin në shoqëritë e mëhershme nuk ishin product i factorëve natyrorë, por produkt i faktorëve të trajtimit të shoqërisë. Sipas tyre femra posedon aftësi psikike dhe fizike që të merret me të gjitha veprimet që i ushtron mashkulli, por shoqëria ishte ajo që nuk i dha rastin femrës që të demostroj personalitetin e saj. Ajo është e shkathët të punoj krah për krah me mashkullin sikur të eliminoheshin faktorët që e pengojnë këtë process.

Sipas një antarie të kësaj lëvizjeje Neval S'adam e cila thotë: *botëkuptimet tradicionale se femra është përgjegjëse për edukimin e gjeneratave dhe shërbimet shtëpiake, kurse mashkulli është përgjegjës jashta shtëpisë, janë botëkuptime të gabuara që burojnë nga faktorët shoqërorë që femrën e kanë vënduar në pozitë të palakmueshme.*¹³

Sipas parimeve thelbësore të lëvizjes për emancipimin e femrës, femra nëse dëshiron ti tregoj aftësitë dhe aktivitetin e saj duhet të dëshmoj se është e gatshme për ekuivalencë të plotë në kryerjen e ndonjë funksioni, pozite dhe punëve fizike, në vend se të punoj si edukatore dhe nënë në shtëpi. Sipas tyre femra që të jetë e emancipuar duhet të lirohet nga mendimet dhe besimet në çështjet metafizike dhe fetare. Thënë shkurt, në bazë të asaj që nënkuptohet nga apelet e tyre për emancipim, respektivisht në barazi të plotë midis dy gjinive, në çlirim nga tutorizme dhe në flakje të paragjykimeve të kota, realisht ata apelojnë që njerëzit të veprojnë në kundërshtim me natyrën e krijimit të tyre, apelojnë që femra të lirohet jo vetëm nga prangat e robërisë, por edhe nga prangat e tutorësisë, moralit, ndjenjave dhe tipareve femërore të saj.

Padrejtësitë e mëparshme nuk guxojnë të jenë arsye për padrejtësitë dhe devijimet pasuese. Një fjalë e popullit thotë: "Dhembja e kokës nuk shkon duke e ndruar jastëkun". Është anomali-sëmuri duhet shëruar

¹³ *Po aty, f. 85*

sipas dozës që kërkon ajo, sepse mjeku po i dha pacientit dozë të tepruar ose joadekuat për sëmundjen, mund të shkaktojë pasoja të mëdha dhe serioze.

Kur flasim për emancipimin e femrës, nëse flasim pa e definuar dhe përkufizuar mirë të kuptuarit e emancipimit, është çështje shumë e rrezikshme si për individin ashtu edhe për shoqërinë. Është e emancipimit nuk shërohet duke e zgjerruar apo ngushtuar rrethin e ndalimeve apo të lejimeve varësisht nga trendet ekonimike, politike dhe shoqërore, por ajo shërohet duke iu përmbajtur parimeve dhe principeve stabile.¹⁴

Meqë Suedia konsiderohet shtet që më së shumti është dhënë pas emancipimit të femrës, për studimin e kësaj çështjeje kombet e bashkuara kishin caktuar një juriste- avokate nga suedia që të studioj në këtë çështje. Avokatja Birxhid nga Suedia në fund të hulumtimeve të saj, kishte sjelluar një raport me ç'rast ne do të shkëpusim nga ai këtë pjesë: Femra skandinave pas shumë peripecive dhe lodhjeve që kishte përjetuar për të fituar të drejtat e saj, për barazi me mashkullin, ajo u zhvesh nga cilësitë e saj femërore dhe liria e saj femrore me qëllim që sa më afër t'i afrohet mashkullit. Liria e saj nënkuptonë lirinë e banorit të xhenetit që tenton të zbresë në tokë, apo sikur liria e

¹⁴ *Ebu Halil Shevki, tahrirul mer'eti mi-men ve fima hurr-rrij-jetuha, darul fikr 1998, Damask-Siri*

shqiponjës që të bëhet sorrë, ashtu është liria e femrës që të bëhet mashkull.¹⁵

Në bazë të një raporti nga organizata e kombeve të bashkuara që publikohet në vitin 1985 përveç tjerash thuhet:

- 12 milion fëmijë në amerikë janë të bastarduar,
- 25 milion të goditur nga sëmundjet e ndryshme si pasojë e amoralitetit,
- në Evropë 75 % është evidente tradhëtia bashkëshortore,
- Deri në vitin 2000 me virus të sidës infektohen 40 milion njerëz, nëse ajo vazhdon me të njëjtin trend, kurse shpenzimet janë shumë të mëdha dhe pa sukses.¹⁶

Kur flasim për emancipimin pyesim: Emancipim prej kujt dhe nga kush ??

Nëse përgjigja është; emancipim nga padituria, devijimi dhe analfabetizmi, themi: Po. Nëse thuhet se me emancipimin nënkuptojmë rolin e femrës në familje dhe shoqëri, themi; Po. Nëse thuhet emancipim nga gjërat mitologjike dhe bestytënitë, themi; Po. E nëse thuhet emancipim nga mbulesa, morali, turpi, besimi, themi Jo, sepse kjo sjellë pasoja vetëvrasëse.

¹⁵ *Po aty, f.33*

¹⁶ *Po aty, f.52-53, nga revista El Xhamia Nr.287 të datës 28 shtator 1985, f.11-13.*

(PA)BARAZIA MES FEMRES DHE MASHKULLIT

Lëvizjet kinse për emancipimin e femrës janë ngritur mbi baza euforike dhe joshëse për plotësimin e interesave të ndryshme të shoqërive dhe për plotësimin e ndjenjave të epshit. Pikërisht ky është motivi që këto lëvizje në start të jenë të gjykuara me dështim, por thënë realisht me shumë pasoja në integrimin e shoqërisë duke e prishur dhe rrënuar qelinë e parë të shoqërisë, familjen.

Lëvizjet për emancipimin e femrës kanë mundësuar që shtete të përparuara të bëjnë sistem të ligjeve që garantojnë barazinë e dy gjinive në të gjitha sferat e jetës, por megjithatë realiteti është ndryshe, ngase femra përsëri nbeti e pabarabartë me mashkulin. Sot bota bashkëkohore ka evituar të gjithë factorët që lëvizja për emancipim i trajtoi si barrikada për barazibnë e plotë midis dy gjinive, por përsëri rezultati mungon.

Nga tërë këto orvatje u fitua vetëm edhe një dështim i femrës duke humbur vlerat e mirëfillta si psh, turpin, moralin, menjëfale vlerat e krijimit të saj. Këto teori e nxorën femrën nga shtëpia, e nxorrën para syve

të botës që ajo të ekspozoj lakuriqësinë e saj, e bënë të shetis krahë për krah me burrin duke humbur vlerat e një nëne me ndjenja të shëndosha, të një edukatorie të ndershme, ndikuan që femra të humbë gjithçka të saj, por nuk ia bënë të mundshme që t'ia arrij qëllimit të saj.

Nga kjo nënkuptohet se dallimet që bëheshin midis mashkullit dhe femrës nuk bëheshin për shkak të faktorëve që konstatuan apeluesit për emancipimin e femrës, por nga faktorë që mbështetën në natyrshmërinë e krijimit të femrës, sepse po të ishte ashtu, atëherë me evitim të faktorëve shoqërorë, do të arrihej edhe rezultati i dëshiruar, por kjo akoma nuk ndodhi.

Ky është argument për intelektualët dhe shkencëtarët e mirëfilltë që sinjalizon se përcaktimi i diagnozës është i gabuar. Për këtë arsye ky dështim ishte një zile alarmuese për shkencëtarët që problemin ta ristudjojnë esencialisht që nga fillimi. Andaj, shkencëtarët duke bërë analiza të shumta dhe të hollësishme dolën me konkluzën shkencore se dallimi midis dy mashkullit dhe femrës nuk bëhet për shkak të faktorëve shoqërorë, siç u tha deri më tani, por për shkak të faktorëve biologjik që ndikojnë edhe gjatë krijimit të tyre, respektivisht para lindjes.

Lidhur me këtë studjuesi dhe teologu i njohur kosovar N. Ibrahim duke u mbështetur në mendimet e disa dijetarëve Islam thekson se ; barazia (midis femrës dhe mashkullit J.Z) është i pakuptimt në atë mënyrë sikur edhe diskutimi mbi barazinë e trëndafililit dhe jaseminit. 'donjëri ka aromën e vet, formën dhe

bukurinë e vet. Mashkulli dhe femra nuk janë të njëjtë, çdonjëri ka funksionin dhe karakteristika të ndryshme. Femrat nuk janë të barabarta me meshkujt përkësisht për atë shkak se as meshkujt nuk janë të barabartë me femrat. Islami i koncipon funksionet e tyre në shoqërinë muslimane jo si antagonistë por si komplementariste. Çdonjëri ka detyrat që janë në pajtim me natyrat dhe konstitucionin specifik.¹⁷

Barazia moderne në të cilën insiston perëndimi është aplikimi i një parimi juridiko-social në një lëmi thuajse të pa përshtatshme, me çka nivëlizohen dallimet objektive psikofizike, kurse femës i bëhet dyfish e padrejtë me represionin e natyrës së saj, përkatësisht femërores dhe humbjen e privilegjeve që në shoqërinë normale implikon natyrën enjëjtë. Prapavia ekonomike e “barazisë” është njëdemagogji e llojit të vet në funksion të alibit, me të cilin dëshirohet të mbulohet sistemi i eksploatimit fizik dhe shpirtëror të femrave në universumin e mbyllur të prodhimit dhe konsumimit.¹⁸

Për dallimet që ekzistojnë mes dy gjinive, gjegjësisht për absurditetin e barazisë midis mashkullit dhe femrës falsin edhe argumentet shkencore e racionale.

Hulumtuesi amerikan Steven Golberg në veprën e tij botuar në vitin 1977 përveç tjerash shkruan: Dallimet midis mashkullit dhe femës nuk bëhet për shkak të

¹⁷ N. Ibrahim, *Islami në trojet tona iliro-shqiptare gjatë shekujve*, f.95

¹⁸ Po aty.

factorëve shoqërorë, por ato janë dallime në natyrshmërinë e krijimit të dy gjinive.

Studijuesi ndonëse u ballafaqua me ithtarët e lëvizjes për emancipimin e femrës duke e fyer dhe anatemuar, ai përsëri qëndroi stabil në qëndrimin e tij duke mos dashur të konfrontohet me realitetin shkencor dhe vazhdon duke sqaruar se; Dallimet midis dy gjinive janë rezultat i natyrshmërisë së hormoneve të clat ndikojnë te fëmia derisa ai të jetë në barkun e nënës. Për këtë arsye shohim se fëmijët meshkuj anojnë më shumë nga fuqia dhe dhuna se sa femrat, bile edhe atëherë kur tek ai akoma nuk ka ndikuar faktori shoqërorë.”

Mirëpo, kjo nuk don të thotë se mashkulli është më i mirë se sa femra, por nënkuptonë se mashkulli dallon nga femra.

Gjithashtu shkencarisht është konstatuar se dallimet midis dy gjinive fillojnë që në fillimin e foshnjës në barkun e nënës.

Studijuesi Dr. Aleksis Kareli, fitues i çmimit Nobë lidhur me këtë çështje të dallimit midis gjinive do të konstatoje se: dallimet midis mashkullit dhe femrës nuk janë vetëm në gjymtyrë si pjesë organike siç janë ani i saj dhe paraqitja e shtatzënisë, por dallimet kanë të bëjnë me natyrën e krijimit të saj. Dallimet janë të rezultuara nga vetë krijimi i pëlhurës dhe nga sistemi i absorbimit të elementeve kimike që dalin nga vezorja. Andaj, këto fakte i injoëuan anëtarët e lëvizjes, atëherë kur kërkauan identitetin e barabartë midis mashkullit dhe femrës si në arsim, sundim, pushtet dhe

përgjegjësi të njejtë, sepse dallimet midis tyre janë të thella dhe esenciale.

Shkencëtari rus Anton Nemilov, kur flet për barazinë e femrës me mashkullin, midis tjerash thotë: "Barazia e plotë midis dy gjinive nuk është çështje e thjeshtë, andaj nuk duhet të ushqehemi me shpresa të rrejshme. Në bashkimin sovjetik janë bërë përpjekje mnë shumë se në çdo vend tjetër në botë për këtë çështje, por realiteti është diç tjetër. pabarazia midis dy gjinive nuk bëhet për shkak të gabimeve praktike, por kjo teori ndeshet me fuqinë e natyrës, e cila ka rolin e saj, pra ndeshet me realitetin se dy gjinitë nukmund të barazohen nga aspekti biologjik, andaj edhe obligimet dhe përgjegjësia janë të pabarabarta.

Andaj, ligjet fiziologjike që kanë të bëjnë me funksionimin e pjesëve të trupit të njeriut janë statike sikur edhe ligjet që kanë të bëjnë me lëvizjet e yjeve në kosmos. Ata nuk mund të ndryshohen për shkak të dëshirës së njeriut. Pikërisht për këtë duhet pranuar vetëm ashtu si janë, sipas natyrës dhe sistemit që Krijuesi i ka bërë të funksionojnë.

Nisur nga parimet tanimë mirë të argumentuara në mënyrë autentike, shkencore dhe fetare lehtë konstatohen dallimet midis dy gjinive. Ekziston teoria e çiftësisë, që nënkupton se çdo gjë është krijuar çift, andaj edhe qenia njerzore është e krijuar çift, respektivisht mashkull dhe femër. Urtësia dhe sekretet e këtij krijimi në këtë formë i din vetëm Krijuesi, Allahu xh.sh., kurse njeriu mësoi diç për realitetin e funksionimit të kësaj ndarjeje, ngase cilës do palë t'ia

mohosh funksionimin ose të tentosh ta shëndrrojmë në funksion të çiftit të tij, është e sigurt se jo vetëm që do të mungoj efekti dhe rezultati konstruktiv, por do të shkaktohen çrregullime serioze në shoqëri.

Po të bësh njësimin e funksionimit të telave të rrymës, qoftë pozitiv apo negativ, atëherë është e sigurtë se do të mungoj drita. Është e ndodhte në botë sikur të mos ekzistonte ligji i çiftësisë, athua do të kishte ujë, shi etj, etj.

Shembuj të tillë ekzistojnë shumë në univers, por në fund cila do të ishte përgjigja e pyetjes se; vallë sikur femra dhe mashkulli të kenë përgatitje dhe aftësi për të kryer punë, funksione dhe veprime të njejta, atëherë cila do të ishte nevoja e ndarjes së qenies njerzore në dy gjini ?. Sigurisht se kjo ndarje do të ishte e tepërt.!!!

Mendoj se thirrësit në emancipimin e femrës në këtë konotacion të fjalës, me tentativë për të evituar iluzionet dhe bestytënitë nga shoqëritë e lashta, kanë rënë në një iluzion tjetër që është jo më pak i dëmshëm, jo vetëm antiislam dhe antishkencor, por është kundër natyrës njerzore.

QENDRIMI I ISLAMIT DHE TE DREJTAT E FEMRËS

Të jesh i përkryer pa mëkatë, s'është njerzore, por të gabosh dhe të pendohesh është njerzor.

A. Izetbegović

Që në fillim duhet theksuar se mashkulli në Kur'anin famëlartë është përmendur 24 herë, po aq herë sa është përmendur edhe femra.

Nëse mund të themi se lëvizja për emancipimin e femrës iu kundërvua padrejtësive që ushtroheshin ndaj femrës nga shoqëritë e mëhershme barbare, që fundamentet e funksionimit dhe zhvillimit të bazoheshin në mitologji dhe bestytëni të ndryshme, atëherë patjetër të theksohet si Islami këtë veprim, këtë betejë e kishte zhvilluar afër njëmbëdhjetë shekuj më herët.

Sistemi Islam i rregulluar nga i Gjithëfuqishmi, në mënyrë të saktë dhe pakompromis i luftoi dhe në kontinuitet i lufton të gjitha iluzionet mitologjike të popujve të ndryshëm, kurse qenien njerzore pa dallim race dhe gjinie e trajtoi të barabartë duke u dhënë obligime dhe përgjegjësi konkrete, që pajtohen jo

vetëm me natyrën e krijimit të tyre, por edhe me zhvillimet fiziologjike dhe psikologjike të tyre. Islami për herë të parë e liroi botën njerëzore në përgjithësi nga iluzionet dhe mitologjitë e ndryshme, kurse gjininë femërore nga të gjitha llojet e robërisë. Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“O ju njerëz, kini frikë Zotin tuaj,që ju krijoi prej një veteje(njeriu) dhe nga ajo krijoi palën tjetër (shoqen e saj), e prej atyre dyave u shtuan shumë burra e gra.”¹⁹

Nga ky ajet qartë vëhet në pah se mashkulli dhe femra janë dy pjesë të një tërësie, janë pjesë të vetme përbërëse të familjes, kurse nga ana tjetër familja është bërthama e shoqërisë²⁰. Femra dhe mashkulli janë dy anë të një realiteti, ose thënë shkurt janë si dy anë të hënës, ose dy anë të një medaljeje²¹. Prandaj, sado që të flitet dhe çfarëdo që të flitet për femrën dhe mashkullin për rolin dhe funksionin e tyre në jetën njerëzore, një gjë është e qartë, e qëndrueshme dhe e pakontestuar se; femra plotëson jetën e mashkullit dhe anasjelltas mashkulli plotëson jetën e femrës. Pa njëri tjetrin nuk mund as të paramendohet lumturia dhe prehja. Andaj raportet mes tyre janë plotësuese e jo

¹⁹ *En Nisa : 01*

²⁰ *H. Gjozo, Hyrje në Islam, f. 260*

²¹ *Adnan Es-sebij, Es-sih-hatu en-nefsij-je lil mer'eti vel um-mi, f.10 darul fikr, Damask-Siri*

mbivlerësuese, kurse pyetja se cili prej tyre ka peshë më shumë në jetë është absolutisht e pavend.²²

Femra është gjysma e shoqërisë njerëzore, andaj Islami nuk mund të perceptoj që të rrënojë gjysmën e shoqërisë dhe në atë mënyrë ta paralizoj shoqërinë. Sipas Islamit femra është entitet i pavarur. Islami asaj i drejtohet, e nuk i qaset me ndërmjetsimin e meshkujve, ashtu siç edhe ajo ka të drejtë t'i drejtohet Allahut xh.sh. pa kurrëfarë ndërmjetsimi.²³

Njeriu ka nevoj për një rend shoqërorë i cili do t'i mundësoj atij ta vërtoj qëllimin e krijimit dhe të shfrytëzoj fuqinë e mendjes, të dijes dhe të eksperimenteve për formimin e një sistemi të përshtatshëm për nevojat reale njerëzore dhe kërkesat e aspiratave të natyrshme të tij.²⁴ Njeriu, qenia e vetme në tokë, e pajisur me të menduarit, ka për obligim të angazhohet dhe të hulumtoj të vërtetën, të drejtën, të arsyeshmen dhe të moralshmen duke i kërkuar argumentet e bazës së tyre të shëndoshë. Kështu Islami në mënyrë të saktë ka rregulluar pozitën e dy gjinive në shoqëri duke përcaktuar përgjegjësinë e femrës si vajzë, si bashkëshorte e ndershme, kurse sa i përket rolit të saj si nënë, e ngriti në pedestalin më të lartë duke e quajtur si shkollë, përkatësisht institucion në vete. Ndoshta pikërisht këtu qëndron edhe urtësia që Islami i

²² *Po aty, f. 9-10*

²³ *Dr. El Kardavi Jusuf, el fetava muasire, 2/304.*

²⁴ *El Mevdudi ebul eala, Organizimi i jetës në Islam, f36, Rumi 1997 Tetovë*

ka bërë nderim të posaçëm femrës, ngase ajo si pedagoge e mirë ndaj fëmijëve, i hapë shtigjet e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë.

Sistemi Islam është sistemi i parë shoqërorë që femrës ia ka kthyer të drejten e shprehjes së mendimit të lirë, e drejtë kjo e uzurpuar pa dëshirën e saj. Me këtë hap femra përfiton statusin e saj të realt. Këtë të drejtë femra islame e përfitoi me rastin e zbdritjes së pesë ajeteve tëpara që zbritën Muhamedit a.s. kur Hatixhja dha mendimin konkret, e Pejgamberi a.s, e pranoi si të tillë. Pastaj këtë mund ta vërtetojmë edhe nga veprimtaria e Aishes r.a. e cila ishte mjaft e dëgjuar në përgjigjet e saja të palodhshme për t'i paraqitur mendimet e veta në sferën e jurisprudencës.

Historia e Islamit në kontekst të kësaj, regjistron një ngjarje shumë të rëndësishme në kohën e Omerit r.a. Halifi i dytë i muslimanëve, Omeri r.a. kishte vërejtur shtrnjtimin e mehrit. Me qëllim të preventivës dhe të eliminimit të kësaj dukurie si dhe me qëllim të shërimit të kësaj plage sociale gjatënjë ligjrate në Xhami, përmend të drejtën e femrës dhe thotë: “Mos të rritet sasia e mehrit më shumë se 40 derhem, me qëllim lehtësimi të martesës . Nëse dikush tejkalon këtë sasi, unë tepricën do ta deponoj në arkën shtetërore.” Me këtë rast si duket Omeri përmes mendimit të tij drejtpërdrejtë kishte cenuar të drejtën esenciale të femrës, cenim ky i cili nxiti njërën nga gratë e pranishme t'i drejtohet Omerit duke i thënë: O Omer, o prijës i muslimanëve, kjo nuk është e drejtë e juaja. A po na e ndalonë atë që na e lejoi Allahu xh.sh. ? dhe

menjëherë ia lexoi ajetin 20 të sures en Nisa. Me të dëgjuar këtë Omeri përsëri mori fjalën dhe iu drejtua masës me këto fjalë “Gruaja ka të drejtë, kurse Omeri gaboi.”

Nga kjo ngjarje, qartë del në shesh se paraqitja e mendimit të argumentuar është e drejtë esenciale e femrës dhe ka fuqi të nënshtrojë mendimet e paargumentuara pavarësisht se nga kush burojnë. Gjithashtu femra sipas parimeve Islame ka të drejtë që me konsekuencë të mbrojë identitetin dhe të drejtat e saj që ia dhuroi Allahu xh.sh. si qenie njerzore dhe shoqërore.

Për herë të parë në histori, Islam e drejta isleme i mundësoi femrës që ajo vet të vendos për vete dhe për fatin e saj. Gjithashtu është mjaft me rëndësi fakti se Islami në bazë të rregullave juridike, femrës për herë të parë i ka mundësuar të drejtën e pronësimit, përkatësisht të drejtën e trashëgimisë nga i ati, vëllai, djali dhe bashkëshorti i saj. Allahu xh.sh. në Kur'anin madhështorë thotë:

“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit (pas vdekjes) dhe femrave ju takon pjesë nga ajo që e lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që e lënë, ju takon pjesë e caktuar.”²⁵

Me zbritjen e ajeteve kur'anore që përcaktojnë trashëgimtarët, arabët mbetën të habitur me qëndrimin e Islamit ndaj të drejtës së trashëgimisë së femrës,

²⁵ En Nisa : 07

andaj tentuan të kërkojnë nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. t'i mënjanoj këto dispozita që kanë të bëjnë me të drejtën e trashëgimisë, por qëndrimi i Islamit ishte i prerë në këtë kontekst dhe nuk mund të dirigjohet nga logjikat e njerëzve²⁶.

Sipas Islamit, femrës jo vetëm që iu dha e drejta e pronësimit, por ajo fitoi të drejtën që me pronën e saj të qeverisë e pavarur dhe të bëjë çfarëdo lloj kontrate që islamikisht është e lejuar. Përveç kësaj, ajo kishte të drejtë të lidhë edhe kontratën e Martesës. me këtë rast, nëse palës nën presion i imponohet kontrata, atëherë sipas parimeve të jurisprudencës islame një gjë e këtillë konsiderohet krim dhe shkelje flagrante mbi të drejtën personale që ia ka dhuruar Islami.

Femrat, sipas parimeve Islame kanë të drejtë të marrin pjesë aktive edhe në përhapjen dhe zgjerimin e diturisë duke urdhëruar në të mirë dhe ndaluar nga e keqja.

Femra muslimane duhet të udhëzohet bile edhe në shkathtësitë dhe strategjitë luftarake, sepse në rast nevojë edhe ajo është e obliguar të mbroj atdheun. Kështu veprohej në kohën e të Dërguarit të Allahut xh.sh. ku gratë mernin pjesë në ekspeditat ushtarake duke luajtur rol aktiv siç ishte rasti në betejën e Uhudit. Umi Atije thotë: shtatë herë kam pjesë në luftë me Muhamedin a.s. duke kryer punë të rëndësishme,

²⁶ J. Zimeri, *E drejta e trashëgimisë në shariatën Islam*, f. 07 Shkup 1999.

përgatitnim ushqimin, mjekonim të lënduarit dhe u shërbenim të sëmuarve.²⁷

Ndërkaq, duhet theksuar se për kryerjen ose moskryerjen e obligimeve të saj ndaj shoqërisë, Islami ka përcaktuar përgjegjësi për veprat e saj, me ç'ras Allahu xh.sh. thotë:

“Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit”²⁸

Sa i përket raportit bashkëshortor midis veti, njeiu sado që të bëjë studime, mesiguri nuk do të mund të gjejë shprehje më të çmuar dhe më të ëmbël se ajeti kur'anor i cili qartë ndriçon rolin e femrës duke thënë:

“Dhe nga faktet e madhërisë së Tij, është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vet lloji i juaj palën (femrën) ashtu që të gjeni prehje tek ato, dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”²⁹

Në shoqëritë ku femra nuk i gëzonte këto të drejta elementare, këtë prestigj, ajo ishte e detyruar të falsifikoj pamjen e vet fizike me mjete artificiale kozmetike dhe operime plastike, vetëm e vetëm për të qenë sa më joshëse ndaj meshkujve. Nga e tërë kjo që u përmend, mund vetëm të përforcohet konstatimi i dijetarit Islam H. Gjozo i cili thotë: ” Për ndryshim nga Evropa, në islam femra dhe mashkulli janë të barabartë në dinjitet, në arsimim, në edukim, dhe në aktivitete

²⁷ *El Kardavi Jusuf, fetava Muasire, 2/268*

²⁸ *El En'am : 164*

²⁹ *Err-rrum : 21*

tjera, varësisht nga predispozicionet psiko-fizike, e assesi priori në çdo aspekt.³⁰

Për të drejtat e femrës në adresë të Islamit shumë janë bërë spekulime të shumta se kinse Islami e mbylli femrën Brenda mureve dhe në këtë mënyrë e stagnoi shoqërinë njerzore!! Në këtë drejtim për t'i flakur spekulimet e njerëzve joqëllimshëm, dijetarët Islam shpeshëherë kanë reaguar dhe kanë sqaruar me fakte dhe argumente fetare dhe shkencore. Lidhur me këtë dijetari dhe juristi i mirënjohur Islam Dr. Jusuf El Kardavi përveç tjerash thotë: Femrën e kanë dëmtuar dy rryma të njerëzve;

- Propeëndimorët (modernistë) që femrës ia impononin traditat perëndimore duke përfshirë edhe lirinë e saj epshore të çliruar nga ndjenjat fetare, etike bile edhe ato natyrore. Kjo kategori harruan ankesat e femrës së perëndimit dhe atë që po ndodhë në perëndim.

- Prolindorët (fanatikët) që femrës i imponuan traditat e lindjes, bile shpeshëherë në emër të fesë, duke e mbyllur atë në shtëpi brenda mureve. Mirëpo, sipas realitetit Islam femra nuyk guxon të jetë e burgosur siç pretendojnë të dytit, por gjithashtu nuk guxon që në asnjë mënyrë të jetë e shfrenuar tërësisht siç pretendojnë të parët.³¹

³⁰ Husejn Gjozo, *Hyrje në islam*.

³¹ Dr. El Kardavi Jusuf, *fetava muasire* 2/278

ROLI I FEMRES NE FAMILJE DHE SHOQËRI

Shthurria e familjes është atëherë kur femrës i jepet roli që asaj nuk i përshkruhet në ndershmëri dhe respekt.

Shevki Ebu Halil.

Institucioni më i rëndësishëm që ekziston në shoërinë njerëzore është familja, e bazuar mbi një çift. Familja është gjithashtu institucioni ku çdo grup shoqërorë ia përcjell gjeneratës së re parimet morale, përgjegjësinë, mirësjelljen dhe ndihmën reciproke midis njerzve.³²

S'ka dyshim se të gjithë sociologët, pedagogët, mjekët dhe shkencëtarë tjerë që u morrën me këtë lëmi janë të mendimit se familja është faktor i rëndësishëm për edukimin e fëmijës, adnajt me të drejtë thuhet se një shoqëri e shëndoshë, progressive dhe e emancipuar është vetëm atëherë kur kemi familje të shëndoshë dhe të edukuar mirë.

³² El Mevdudi Ebul eala, Organizimi i jetës në Islam, f.36 Rumi 1997 Tetovë

Qetësia, rehatia dhe siguria që afron familja stabile janë premisa të domosdoshme në përparimin shpirtërorë e material të anëtarëve të saj. Rregllimi i harmonisë së shoqërisë sendërtohet në rregullimin e familjes, ndërsa fëmijët paraqesin thesarin dhe dhuntinë më të çmueshme të Allahu xh.sh.³³

Dr. Ali Sheriati, për sendërtimin e qenies njerëzore thekson pesë faktor relevant që janë; prindërit (nëna dhe babai), shkolla, mjedisi shoqërorë dhe dukim-arsimimi.

- Roli dhe ndikimi i nënës në familje ndërton strukturën dhe dimensionin shpirtërorë të familjes dhe njerzimit në përgjithësi. Nëna ushqen shpirtin duke i dhënë atij ndjenja subtile. Fëmijës që thithë qumshtin nga gjiri i nënës si dhe lëvizjet e saj të veçanta ia japin atij mësimin e parë.
- Faktori i dytë në ngritjen e qenies njerzore është ai i cili formon dimensione tjera të shpirtit të fëmijës.
- Faktori i tretë formon dhe krijon dimensionin e qartë të qenies njerzore.
- Gjothashtu edhe rrethi dhe shoqëria janë faktor relevant
- Faktori i pestë në sendërtimin e qenies njerzore është kultura e përgjithshme e kombit, apo kultura e përgjithshme e botës.³⁴

³³ *Xhabir Hamiti, Takvim 1421/2001, Prishtinë.*

³⁴ *Dr. Ali Sheriati, Kultura dhe ideologjia, f.31-33, Tetovë 1992.*

Pra, familja nuk mund të jetë e ekuilibruar, vetëm me një administrim të mirë të punëve. Duke vështuar faktorin e parë në sendërtimin e qenies njerëzore, qartë del në skenë roli i femrës në ngritjen e rendit shoqërorë. Në këtë kontekst dijetari i njohur M.M. Esh Sha'raviu thotë: “ mashkulli merret me çështjet më pak se njeriu, kurse femra me veprimtarinë e saj kryesore që është sendërtimi i qenies njerëzore”. Kjo don të thotë se rëndësia dhe pesha femrës është pushim për bashkëshortin dhe prehje e fëmijës, veprim ky që femrës i dhuron rolin më të ndershëm në ekzistencë. Këtë femra duhet ta pranoj me krenari dhe nder.³⁵

Me të drejtë Islami femrën – nënë e kishte konsideruar si edukatore të mirëfilltë duke e quajtur atë edhe shkollë, andaj nëse kjo shkollë nuk i kryen obligimet e saj, atëherë këtë mungesë nuk mund ta kompensoj askush tjetër. Pedagogët dhe sociologët kanë konstatuar se edukimi i gabuar i fëmijës në moshën e hershme është tragjedia më e madhe për jetën e fëmijëve edhe për shoqërinë në përgjithësi.

Nisur nga ky fakt, lehtë mund të konstatohet se roli dhe rëndësia e femrës, për sendërtimin e shoqërisë në përgjithësi, duke filluar nga bërthama përkatësisht familja është pa alternativë. Pikërisht për këtë veprimtari të ndeshme, apo siç thotë Dr. Jusuf El Kardavi për këtë emanet të respektuar, nuk guxon të

³⁵ *Mutveli esh'aravi, elkur'anul kerim, mu'xhizetun ve menhexhun, f.537, darun-nedve el xhedide, Bejrut 1987.*

ndikoj ndonjë faktor tjetër që do të mund ta largojë nga kjo veprimtari. Këtë veprimtari në asnjë mënyrë nga askush nuk mund të kopmpensohet, ngase nga ko varet ardhmëria e popullit.

Erih From thotë:” Fëmijës i duhet dashuria dhe kujdesi i pakushtëzuar i nënës, si në aspektin fiziologjik ashtu edhe në atë psikologjik.³⁶ Nëna ka për obligim që fëmijës t’ia mbjellë ndjenjat e sigurisë. Dashuria e nënës është afirmim i pakushtëzuar për jetën e fëmijës dhe nevojave të tij.³⁷ Fëmija edhe pse pas lindjes jeton jsthtë organizmit të nënës, ai edhe më tutje është i varur nga nëna. Nëna është ngrohtësia dhe ushqimi. Nëna është gjendja euforike e kënaqësisë dhe sigurimit.³⁸

Roli i mashkullit në shoqëri është më pak prëcis se roli i femrës, sepse gabimet e mashkullit në veprimtarin e tij më lehtë mund të përmirësohen, kurse gabimet e femrës në edukimin e gjeneratave sjellin pasoja shumë serioze dhe përmirësohen me shumë sakrifica dhe mundime.

Shpeshëherë dëgjohet në shoqëri se faktori kryesor në kryerjen e punëve madhështore është faktori njeri, nga i cili varet prodhimi i përgjithshëm industrial, andaj për ruajtjen e rendit dhe progresit në shoqëri mund ta bëjë vetëm ai i cili është mirë i edukuar dhe i përgatitur, që din të respektoj duke filluar nga rrethi më i ngushtë e më gjërë, gjë që kryesiht varet nga

³⁶ Erih From, *Umetnosta na lubovta* f.49.

³⁷ *po aty*, f.55

³⁸ *po aty* f. 45-47

edukata e përfituar në familje. Nga kjo nënkuptohet se meshkujt bëjnë punë kualitative në industri, ndërsa femra krijon shoqëri kualitative.

Tërë kjo që u tha vërteton rolin e femrës e cila në mënyrë direkte është e kyçur në edukimin e fëmijës, por kjo nuk dtë thotë se mashkulli lirohet nga kjo përgjegjësi, sepse suksesi i femrës në këtë drejtim nuk mund të jetë ipërkryer nëse në edukimin e fëmijës nuk angazhohet edhe i ati i tij. Thuhet kështu, ngase shumë nëna kanë dështuar para fëmijëve të tyre ngase kurorëzimi përkatësisht raportet bashkëshortore nuk janë ndërtuar mbi baza të shëndosha, të dashurisë dhe mëshirës.

Në drejtim të edukimit të fëmijës nga nëna, në këtë rast do të kisha përmendur vetëm gjidhënien. Fëmija që pi gji nga nëna përveç që ushqehet, ai kultivon edhe dashurinë e nënës, që është mëse e nevojshme për zhvillimin e tij psiko-fizik.

Mjeku Abdurrezak Neufel thotë:” prej çudirave që Allahu xh.sh. krijoi në orgaizmin e femrës është edhe gjiri i saj.Elementet kimike që ekzistojnë në përbërjen e qumshtit të nënës janë mbrojtja më efikase e shëndetit të fëmijës nga sëmundjet e ndryshme.”³⁹

Psikiatri Usame Sherbini pas shumë hulumtimeve shkencore, në kongresin mjekësor që u mbajt në fillim të Janarit të 1990 në Kairo, ka kumtuar rezultatet e studimeve të bëra pikërisht për këtë çështje ku thotë:

³⁹ Grup autorësh, I. Abazi etj. *E drejta familjare në Islam*, f.30

- Zhvillimi psikik i fëmijëve që ushqehen me gjirin (qumshtin) e nënës, është shumë më i mirë për dallim nga ata që ushqehen me ushqime artificiale.
- Ndërprerja e gjirit të nënës para kohe në 96 % të fëmijëve shpjen në çrregullime nervore, humbje të përqëndrimit të plotë, qarje të gjatë, pagjumësi, mungesë oreksi etj. Andaj, në fund apelon që për ruajtjen e shëndetit të fëmijës, për zhvillimin normal psiko-fizik si dhe për mbjelljen e dashurisë prindore, fëmija patjetër t'i nënshtrohet thithjes së gjirit të nënës.⁴⁰

⁴⁰ Po aty f. 390, marrë nga revista "El Ilm, rvistë shkencore Nr. 160 Kairo.

ARSIMIMI DHE PUNESIMI I FEMRES.

Femra është qenie e gjallë, andaj nga natyra e saj është që të logjikoj dhe punoj, sepse në të kundërtën nuk do të ishte njeri.

Prof. Dr. Jusuf El Kardavi.

Këto dy segmete janë të ndjeshme jo vetëm në popullatën tonë, por edhe në mbarë shoqërinë muslimane, por jo edhe në parimet e shëndosha Islame, sepse Islami me kohë ka rregulluar këto çështje. Patjetër duhet të themi se këto dy pika janë pikat më manipulative në këtë shoqëri, ku shumica dërmuese duke u thirrur në këto dy segmente thirrën në emancipimin çoroditës dhe shfrenues që aspak s'ka të bëjë me emancipimin e vërtetë.

Arsimimi.

Femra patjetër duhet të arsimohet dhe e drejtë e saj është të zgjedhë se çdo të studiojë. Në këtë drejtim nuk ka kurrëfarë dallimi midis mashkullit dhe femrës. Zbritja e ajteve të para kur'anore, respektivisht nocioni "Ire" (Lexo), që është sinonim dhe motoja Islame i

dedikohet qenies njerzore, pra mashkullit dhe femrës, pa kurrëfarë diferencimi midis gjinive. Për këtë arsye, çdo diskriminim ndaj gjinisë femrore konsiderohet padrejtësi dhe krim që nuk e toleron Islami. Ky ajet kur'anor ka vetëm kushtëzim por për dy gjinitë, se dituria duhet të hulumtohet në emër të Allahut xh.sh. dhe me ndihmën e Allahut xh.sh., dhe të shfrytëzohet në rrugën e Allahut xh.sh.

Islami diturinë e quan dritë, e paditurinë errësirë, dijetarin e cilëson njeri që sheh, kurse të pa diturin të verbër.

Ishim racional kur më parë folëm për rolin e femrës në shoqërinë njerzore, andaj do të ishte krej iracionale që Islami të angazhoj femrën me obligime dhe përgjegjësi aq të mëdha, të vlefshme dhe frytëdhënëse, e në anën tjetër t'ia mohoj të drejtën e diturisë, arsimimit, do të thotë të drejtën e përgatitjes për kryerjen e këtij misioni të shenjtë.

Posaçërisht femra duhet të edukohet dhe arsimohet për rolin e saj si nënë. Ajo duhet të jetë pedagoge dhe psikologe shumë e mirë. Në duart e saj formohet dhe edukohet qenia më e ndërlikuar në botë. Ky është funksion shumë i rëndë, i ndërlikuar dhe me përgjegjësi. Shumë më lehtë është të ndërtosh qytete dhe fabrika, se sa të ngritish dhe edukosh një njeri.⁴¹

Nëse shqyrtojmë historinë e mëhershme Islame, vërejmë se në kohën e Muhamedit a.s. seancat e diturisë të organizuara nga vetë Muhamedi a.s. nuk

⁴¹ *Husejn Gjozo, Hyrje në Islam, f. 269*

ishin karakteristikë vetëm e meshkujve, ngase ato ligjerata ndiqeshin edhe nga femrat, bile pejgamberi a.s. për femrat kishte organizuar ligjerata të veçanta për mësim.

Punësimi.

Të gjitha punët e ligjshme që Islami i lejoi për meshkujt janë të lejuara edhe për femrat, e të gjitha ato që i ndaloi për meshkujt i ndaloi edhe për femrat.

Nga kjo nënkuptohet se femra ka të drejtë të ushtroj të gjitha veprimet që në esencë janë të lejuara, pavarësisht se bëhet fjalë për profesione të ndryshme nga lëmia e industrisë, tregëtisë, bujqësisë, arsimit, apo diç tjetër. Në kontekst të kësaj Dr. Jusuf El Kardavi thotë: Allahu xh.sh. krijoi njeriun dhe e sprovon atë për t'i vlerësuar në të mirë apo të këqinj, gjë që bëhet përmes punës, dhe për këtë parasheh shpërblim apo ndëshkim⁴².

Dijetari i njohur bashkëkohor Dr. Ramadan El Buti, këtë problematikë e shkoqitë në bazë të parimit se, puna ndonjëherë është domosdoshmëri, e ndonjëherë nevojë, e ndonjëherë e mirë. Në këtë kategorizim kur për veprime të rëndësishme profesionale bëhen kërkesa të shumta familjare dhe shoqërore, atëher femra nuk ka arsyetim të largohet nga domosdoshmëria në të nevojshme, e mëpas në të

⁴² El Kardavi, *Fetava muasire*, 2/304

mirë.⁴³ Pastaj Buti duke shkoqitur këtë parim citon: Pedagogët janë unik në vendimin se mëkëmbja e bashkëshortes nënë me përgjegjësinë e saj, ruajtjen e interesit bashkëshortor, edukimin e fëmijëve dhe kontributi i saj për rritjen dhe edukimin e tyre të shkëlqyeshëm ngritet në kategorinë e domosdoshmërisë për interesin shoqërorë, sepse familja është fundament për vlefshmërinë e shoqërisë.⁴⁴

Në bazë të këtyre argumenteve mësuam se dijetarët Islam duke u bazuar në argumente autentike Islame janë të një mendimi se femra ka të drejtë punësimi, por nëse punësimi i saj nuk cenon të drejtat e shoqërisë, duke filluar nag bashkëshorti, pastaj fëmija dhe mbarë shoqëria.

Duke dhënë sqarime Dr. Kardavi thot: Puna e femrë jashtë shtëpisë nuk është e ndaluar në esencë, ngase ekzistojnë edhe nevoja shoqërore që kërkojnë punësimin e saj si psh, mjeke pastaj pedagoge etj, mirëpo punësimi i saj jashta shtëpisë kushtëzohet me këto kushte:

- Që puna në esencë të jetë e lejuar, nënkupton të mos jetë veprim i cili është i ndaluar apo shpien në haram si psh, të jetë kamarier ku shërben të tjerët me alkool, pastaj ato veprime ku kushtëzohet lakuriqësia

⁴³ Dr. El Buti Ramadan, *el mer'etu bejne tugjani nidhamil garbij vel-letai'fi teshriir-rreb-banij*, f. 64, *darul fikr, Damask*

⁴⁴ *Po aty*, f.65

apo ekspozimi i trupit të saj, ose punë që sipas parimeve të përgjithshme islame janë të pamoralshme.

- T'i përmbahet parimeve Islame kur del nga shtëpia duke filluar nga mbulesa, ecja, lëvizjet, zëri i saj etj.

- Që punësimi i saj të mos jetë në dëm të obligimeve të saj që i ka ndaj të tjerëve si psh. Ndaj bashkëshortit dhe fëmijëve, sepse ky është obligim primar dhe esencial i saj.⁴⁵

⁴⁵ Dr. El Kardavi Jusuf, *fetava muasire*, 2/305-306

MODA NEN OPTIKEN ISLAME

Jemi dëshmitarë të vërtetë të asaj se kohëve të fundit në emër të emancipimit të rrejtshëm të femrës, praktikohet anomalia më e shumtuar bashkëkohore e që quhet MODE.

Apeluesit në emancipim të vetëquajtur modernistë kanë fituar shprehi që sendet në realitet t'i emërojnë me emra tjerë që nuk kanë të bëjnë me realitetin. Në kontekst të kësaj shpeshëherë dëgjojmë se alkoolin që është nëna e të këqijave, ata e quajnë "pije shpirtërore" imoralitetin "dashuri" ndërsa përzierjen e gjinive dhe lakuriqësinë e quajnë "art". Ata shkojnë edhe më tutje me ç'rast të larguarit nga mësimet Islame e quajnë "progres", ndërsa praktikimin e normave islame e quajnë "regres", ose "reaksionizëm" apo konzervatizëm", dhe të gjithë të tjerët që nuk ndjekin hapat e tyre, por i përmbahen ligjeve Islame quhen; fanatik, intolerant, sektar, ekstremist, fundamentalist, përçarës, e çka jo tjetër.

Pra, moda është dukuri e cila lindi në emër të emancipimit, edhe pse kjo dukuri nuk ka bazë shkencore e as fetare, përveç tekeve të njerëzve për plotësimin e shijeve shtazarake dhe interesave të klasës kapitaliste.

Nocioni "Modë" rrjedh nga gjuha latine *Modus* që don të thotë; tërësia e shijeve, e zakoneve, e dëshirave etj të përbashkëta të njerëzve në një kohë të caktuar që shprehen në mënyrën e jetesës (në veshje, sjellje, në ndërtimin dhe mobilimin e banesave).⁴⁶

Ndodhë shpeshëher që edhe pse ekzistojnë argumente për të vërtetën, shumë njerëz nuk e ndjekin rrugën e argumentit, por qëndrojnë në bindjet e tyre të bazuara në paragjykime të caktuara dhe fatkeqësisht pjesa dërmuese e njerëzve qëndrojnë në këtë pozicion.

Sipas botëkuptimit Islam, gjykimi dhe qëndrimi ynë ndaj disa traditave, shprehive dhe zakoneve nuk mund të mbështetet mbi faktin se në ç'masë traditat janë të përhapura dhe sa konsideohen moderne, por duhet duhet tëmbështeten në faktin e rëndësisë së karakterit të tyre, sa janë të dobishme e sa të dëmshme.

Muslimanët si subject të veprimtarisë dhe aktivitetit të gjithëmbarshtëm të tyre dahut ta kenë kulturën e vet islame të veshjes, të sjelljes, të mënyrës së ushqyerit, të mënyrës së ndërtimit, të mobilimit të banesave, veshmbathjes etj, kulturë kjo që gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë e ndërtuar në përputhshmëri të

⁴⁶ *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Rilindja, Prishtinë 1986*

plotë me dispozitat e moralit Islam, me parimet higjienike bashkëkohore, me shijen e mirë dhe me format estetike.

Nëse vetëm pak me vëmendje shikojmë në modelet e veshëmbathjes, lehtë mund të konstatojmë se moda përsëritet në çdo 30 apo 40 vjetë. Andaj, nëse shkohet pas saj realizohet vetëm interesi i prodhuesit, kurse konsumatori humbë kohë në sende që dëmtojnë e nuk ka dobi prej tyre.

PASOJAT E MODES NE FAMILJE DHE SHOQERI

Kur kemi folur më herët për rolin e femrës në familje dhe shoqëri, kemi thënë se ajo është faktori bazë në ndërtimin e shoqërisë. Pikërisht ky është edhe motivi që femra të sulmohet nga armiqët Islam me qëllim të mosngritjes dhe mosprosperimit të shoqërisë Islame.

Për ata që kanë lexuar diç nga historia e dinë fare mirë për tentativat luftarake të quajtura Kryqëzata, që ishin organizuar për rënimin e Islamit dhe shoqërisë islame. Pas shumë orvatjeve dështuese ata filluan të braktisin këtë metodë të luftës dhe filluan me invazionin psikik, sepse invazoni psikik është më i sukseshëm dhe më efikas se ai fizik. Këtu, filloi lufta për prishjen e moralit të femrës islame, pastaj familjes dhe mbarë shoqërisë. Fatkeqësisht sikur në të gjitha skenarët tjerë edhe kësaj here ekzekutorë dhe agjitant të këtij skenari ishin vet muslimanët, sepse e gjithë kjo ndodhi dhe më tutje po ndodhë në emër të emancipimit të femrës.

Dijetari i famshëm Ali Tantavi thotë: Ne po sulmohemi në dy drejtime: nga ai i dyshimeve dhe i epsheve ⁴⁷

Metoda e parë është më e rrezikshme dhe më e dëmshme, por është process më i ngadalësuar, kurse e dyta është anomaly, e cila përhapet shumë shpejtë, sepse çdo i ri i përgjigjet shumë lehtë epshit të tij.

Në këtë punim të shkurtë, në vazhdim do të theksojmë vetëm disa nga pasojat e këtij emancipimi të rrejshëm, kësaj mode e cila dalëngadalë dhe në mënyrë të qetë shkatërron moralin e qenies njeri dhe e zhvesh ate nga tiparet më të vlefshme të tij.

Ekspozimi i trupit dhe humbja e turpit.

Turpi, është një karakteristikë e cila ka funksionin e mbrojtjes së qenies njerëzore nga devijimet dhe veprimet të cilat njeriun e degradojnë nën nivelin e tij si krijesë më e nderuar dhe më e respektuar në Univers. Njeriu që e humbë këtë tipar, gradualisht fillon të anoj kah dezintegrimi i tij, dhe kah bota e pavlerë.

Në parimet e përgjithshme Islame gjejmë se Islami i kushtoi kujdes të veçant këtij tipari, andaj edhe Pejgamberi a.s turpin e llogariti si pjesë përbërëse të besimit (Imanit) dhe thonte: “**Turpi, është pjesë e Imanit**” Në anën tjetër në një hadith Pejgamberi a.s. ka thënë: **Nëse nuk turpërohesh vepro çka të duash**”.

⁴⁷ Alij Tantavi, *bija ime, përkthyer nga J. Zimeri f. 6, Kumanovë 1997*

Në anën tjetër akaidologët kanë konstatuar se rotori që e ve njeriun në lëvizje të punëve të mira dhe që i jepë fuqi shtytëse dhe inkurajuese është Besimi (Imani) i tij, që nënkuptonë se sa ma i fortë të jetë besimi, aq më i fuqishëm është njeriu në punë të mira, dhe e kundërta është e vërtetë.

Nëse këto dy hadithe të Pejgamberit a.s. i kundrojmë nga këndi analitik, lehtë mund të konstatohet se turpi është pjesë e besimit, dhe humbja e turpin nënkupton humbje të besimit, e nëse njeriu rrezikohet me këtë zhveshje shpirtërore atëherë veprimet e tija janë krejtësisht të pakontrolluara dhe dëmtoese për qenien e tij.

Në anën tjetër është krejtësisht normale dhe racionale se për të ecur në hap me modën – modernizmin, femra duhet t'i përshtatet ligjeve të saj. Sipas parimeve të modernizmit të jeshë e mbuluar don të thotë të jeshë fanatike dhe e paemancipuar, edhe nëse bartë tituj të ndryshëm shkencor, kurse të jeshë pambulesë, atëherë je e emancipuar dhe moderne edhe nëse nuk din shkrim-leximin.

Është realitet se femra Islame është e indeterminuar, por të këqijat shtohen dita ditës, e shkatërrimet dhe çrregullimet e shokojnë pandërpre. Lakuriqësia dhe myopia ndaj saj gjithnjë merr përmasa më të mëdha, kurse shoqëria është indolente ndaj kësaj.

Argumentet kur'anore dhe të sunetit të Muhamedit a.s. që me kohë na kanë sinjalizuar se e keqja vjen hap pas hapi, andaj edhe çdo indolencë për këtë

konsiderohet përgatitje e fushës ku do të shtrihet e keqja. Kur shfletojmë faqet e Kur'anit famëlartë shohim se në suren El Araf, Allahu xh.sh. qartë na tregoi për këtë dukuri.

Dr Vehbi Zuhejli kur flet për komentimin e këtyre ajteve të sures El Araf, thotë: Djalli duke përdorur metoda të ndryshme, bile edhe duke u betuar se është udhëzues i sinqertë dhe ka qëllime të mira në interes të qenies njerzore, arriti të mashtroj Ademin a.s. dhe bashkëshorten e tij Havën, se kinse ndalimi i kësaj peme bëhet për shkak që të mos jeni të pavdekshëm. Tërë këtë e arsyetoi me faktin se ai qëndronë një kohë më të gjatë në Xhenet dhe mir është i njohur me rregullat e tij. Kjo metodë mashtroese që sendet të prezentohen si të mira, është metodë satanike, dhe s'ka dyshim se për këtë njeriu paguajti çmimin e tij.

Dijetari njohur MM Sha'ravi, në veprën e tij, në komentimin e kësaj dukurie thotë: Shpalosja e avretit gjithmonë vetvetiu na përkujton në mëkat. Pra, mëkati është një turp që njeriu gjithmonë mundohet ta mbulojë nga të tjerët. Djalli gjithmonë mundohet që njeriut të keqen t'ia ilustroj si vepër të mirë, e në këtë formë ia prezentoj edhe babës së njerëzisë, Ademit a.s.

Tërë kjo veprohet sipas strategjisë e cila thotë: Nëse më duhesh që të jem i lumtur, atëherë patjetër të shfrytëzoj, të manipuloj me ty, të gjejë metoda dhe sisteme që të përvetësojë.⁴⁸

⁴⁸ *Antoni de Melo, Bugjenje, f.103, LOM.Beograd 1996*

Kurse djetai Sejid Kutbi në veprën e tij⁴⁹ thotë: nga ajetet e mëparë përmendura nënkuptohet se mbulimi i trupit është natyrshmëri e njeriut, kurse lakuriqësia dhe ekspozimi janë çështje aksidentale. Veshja konsiderohet symbol i natyrës së njeriut, kurse lakuriqësia symbol i injorancës dhe shtazërisë.

Nga tërë kjo që u tha deri më tan, nënkuptohet se pranimi i modës, respektivisht nënshtrimi i muslimanes ndaj ligjeve të modës duke e paraqitur atë si akt emancipues dhe modernizëm si dhe progresiv, nënkupton krijimin e një sakrilegie monstruoze, duke u larguar nga mbulesa dhe morali i vërtetë, zotën kjo është edhe insinuata satanike.

Ky është një degjenerim i tërësishëm i shoqërisë që krijon një hipermetropi indolente. Kjo ideologji duke krijuar një ekzibicionizëm të vërtetë e shpien shoqërinë në drejtim të botës shtazore apo e kthen njeriun në kohën e gurit.

Kjo amnezë monstruoze, njerëzit që ende të mobilizuar me moral të vërtetë, ose i apelon të nisen shtigjeve të devijimit, ose i quan anakronik dhe fanatik etj.

Përzjerja e meshkujve me femra.

Në këtë rast do të përkujtoj fjalët e Alija Izetbegoviçit se: mbarësimi artificial nga veterinaria u bart në medicinën humane, e këtu është fjala për një

⁴⁹ *Fi dhilalil Kur'an 3/1270*

lloj përleshjeje ndërmjet humanizmit dhe biologjizmit, ndërmjet individualizmit dhe materializmit.⁵⁰

Femra e cila u nënshtrohet ligjeve të modës ka dëshirë të ekspozohet para meshkujve me qëllim që t'ua tërheq vëmendjen për bukurinë dhe shijen e saj. Ata të cilët apelojnë në përzierjen e gjinive në emër të qytetërimit dhe civilizimit thonë se: përzierja e gjinive mashkull-femër thyen brutalitetin e epshit, ngrit lart moralin, i bënë të qëndrueshëm në krijimin e harmonisë gjinore me ç'rast do të mund të ndal sundimin e epshit seksual. Përzierja shpion në një frigjitet seksual.

Kjo tezë nuk është e vërtetuar, sepse përzierja shkakton një ekstromani të çrregulluar, pasojat e së cilës janë shumë të mëdha.

Në anën tjetër vetvetiu na paraqitet një pyetje e pashmangshme: vallë, frigjiteti, a konsiderohet sëmundje?. Përgjigja është se gjithsesi se po, e për këtë sociologët kanë hulumtuar dhe dikutuar mjaft. Edhe pasojat e frigjitetit nuk janë më të vogla se sa të ekstromanisë.

Në kontekst të kësaj do të sjellim mendimin e një dijetari amerikan i cili nën titullin "Femra amerikane e ftohët: citon: Vërtetë 90 % nga femrat amerikane janë të goditura me frigjitet, kurse 40 % nga meshkujt janë të goditur me sterilitet. "Më pas thotë: Reklamimet dhe

⁵⁰*Izetbegović Alija, islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit, f.129*

fotografitë lakuriqe të femrave amerikane janë shkaktar të frigiditetit për popullin amerikan.⁵¹

Gjithashtu raporti i përgatitur nga komisioni i përgjithshëm britanik për studimin e problemit të çrregullisë seksuale përveç tjerash thotë: Për shkak të përzierjes së gjinive në shoqërinë britanike femra e cila ka braktisur “femërinë” e saj dhe është veshur me cilësitë e burrësirë është shkaktuar lloji i tretë, i cili ndryshon nga burri për nga natyra dhe formimi i saj, kurse ndryshon nga femra për nga veprimtaria dhe obligimet e saj.⁵²

Bota sot si pasojë e përzierjes së gjinive, jeton nën presionin e një revolucioni seksual shtazarak, që i tejkalon të gjitha kufijt, të gjitha normant njerëzore dhe etike. Kjo pasojë nxiti që shumë shkencëtar, dijetar dhe përgjegjës në botë të bëjnë hulumtime dhe të nxjerrin në shesh se një prej problemeve më relevante që i kërcnohet qenies njerëzore është ky realitet, e ndoshta edhe më i rëndësishëm se bomba atomike.

Kjo e nxiti mendimtarin amerikan Xhims Rister që përveç tjerash të thotë: rreziku nga fuqia seksuale e pakontrolluar, veç e ka arritur kulminacionin, bile bile është më i rrezikshëm se sa fuqia atomike.⁵³

⁵¹ *Shevki ebu Halil, Ell Islamu fi kafesil itiham, f.246, darul fikr, Damask-Siri*

⁵² *Po aty, f.247*

⁵³ M.A. El Kutbi, *El hub-bu vel xhinsu fi mendhuril islam, f.130,*

Ky kaos total i shoqërisë si pasojë e përzierjes së gjinive nuk stagnon vetëm këtu, por kaplon situatën e mëtutjeshme duke çrregulluar botën njerëzore. Në librin “Femra amerikane” citohet; në Amerikë gjenden afër 20 milion femra që janë sëmure nga sëmundjet e ndryshme psikike dhe nervore.⁵⁴

Ndodhë ngase në botën e moderuar, përzierja e gjinive jo që nuk konsiderohet mëkat as e dëmshme, por edhe tradhëtia bashkëshortore nuk konsiderohet krim, e për këtë dëshmojnë shumë argumente.

Në Gjermaninë perëndimore më 08.06.1973 parlamenti ka miruar disa ndryshime ligjore që në esencë janë në kundërshtim me etikën dhe ligjërisht ndikojnë në prishjen e harmonisë familjare dhe denigrojnë çdo gjë që është njerzore. Ndryshimet e këtilla që cenojnë dinjitetin e çdo njeriu të vetëdijshëm janë edhe këto.

Lejimi i marrëdhënieve seksuale midis dy meshkujve mbi 18 vjeçar nëse bëhet me pëlqimin e tyre, lejohet shitja e çdo botimi erotik për femrën që i ka mbushur 18 vjet.⁵⁵

Sipas disa të dhënave në Amerikë tradhëtia bashkëshortore ka arritur nivelin e 60 % të meshkujve dhe 40 % të femrave.

Përzierja e gjinive ka shkaktuar pasoja shumë serioze gjë që dëshmojnë edhe shifrat që jepen nga

⁵⁴ Dr. Sejid El Xhemil, *el mer’etu fi mizanit-tibi ved-dini*, f.56

⁵⁵ *Refik ebu Seudi, i’xhazat hadithe ilmije ve rekamije fil Kur’an*, f.56, *darul ma’rife, Damask 1997*.

disa deklarata të njerëzve me përgjegjësi. Sipas një raporti të bërë nga ministria amerikane e arsimit thuhet: Në shumë shkolla të Njujorkit duhet rezervuar dhoma të lindjes, ngase nga pakujdesia përkatësisht amoraliteti shumë vajza të reja- nxënëse mbeten shtatëzënë jashtë martese, dukuri kjo që brengosë, por edhe më brndosëse është edhe shifra 2478 që jepet më 1969.

Kryetari amerikan Xhon Kenedi në fjalimin e tij të vitit 1962 përveç tjerash thotë: ardhmëria e Amerikës është në rrezik, sepse rinia e saj është future në një katrohur denigruese që ka vështirë të dalë ngase mungon gatishmëria e bartjes së përgjegjësisë. Në mesin e çdo shtatë djelmoshave, gjashtë prej tyre janë të paaftë për shërbie ushtarake.

Në Rusi Hrushovi në një deklaratë të bërë për opinion thotë: ardhmëria e Ruisë është në rrezik, sepse rinia e saj është e pasigurtë për shkak të ngulfatjes në epshe.

Një dukuri e tillë i preokupon edhe shumë shtete tjera siç janë Italia, Anglia, Gjermania, Belgjikaa, Austria dhe shumë shtete tjera.⁵⁶

Dhe krejt në fund ndpnëse të gjitha këto janë të dhëna të pakta, por le të shërbejnë si mësim për vetdijësimin e të rinjve në ruajtjen e dinjitetit të tyre, në ngritjen edukativo-arsimore për një ardhmëri më të mirë dhe më të lumtur. Le të mbretëroj logjika e shëndoshë e pasurisë shpirtërore.

⁵⁶ *Fatime Abdulla, Moda nën prizmen Islame, f., 55-58*

Përmbajtja:

Emancipimi

Trajtimi i femrës nëpër shekul dhe shoqëri

Trajtimi i femrës te Hindusit

Trajtimi i femrës te grekët t vjetër

Trajtimi i femrës te romakët

Trajtimi i femrës te arabët para ardhjes së islamit

Trajtimi i femrës në Evropë.

Lëvizja për emancipimin e femrës

(Pa)barazia mes femrës dhe mashkullit

Qëndrimi i Islamit dhe të drejtat e femrës

Roli i femrës në familje dhe shoqëri

Arsimimi dhe punësimi i femrës

Arsimimi

Punësimi

Moda nën optikën Islame

Pasojat e modës në familje dhe shoqëri

Ekspozimi i trupit dhe humbja e turpit

Përzierja e meshkujve me femra

Përmbajtja

Literatura e konsultuar.

Literatura e konsultuar

1. Kur'ani me përkthim dhe komentim në gjuhën shqipe, nga H. Sherif ef. Ahmedi.
2. Nexhat Ibrahim, Islami në trojet tona iliro-shqiptare gjatë shekujve, Logos 1998, Shkup.
3. Ebul Eala El Mevdudi, Organizimi i jetës në Islam, Rumi 1997 Tetovë
4. Husejn Gjozo, Islami në kohë,
5. Grup autorësh, Irfan Abazi etj, E drejta familjare në Islam, Mexhlisi shura i BIM, 1996 Shkup.
6. Dr. Jusuf El Kardavi, Muslimanja e së nesërme, El Islam 1997 Shkup.
7. Jusuf Zimeri, E drejta e trashëgimisë në sheriatin islam, BiM 1999 Shkup
8. Alij Tantavi, Bija ime 1997 Kumanovë.
9. Takvim, 1421/22 – 2001 Prishtinë.
10. Erih From, Umetnosta na ljubovta, biblioteka dopir ZUN pres
11. Andoni de Melo, Budenje, LOM, Beograd 1996
12. Pravna Enciklopedia, Beograd.
13. Dr. Sahmerani Es'ad, El meretu fit-tarih vesh-sheriat, *Femra gjatë historiesë dhe jurisprudencës / darul fikr*, 1998 Bejrut-Liban.

14. Dr. El Buti Ramadan, El mer'etu bejne tugjani nidhamil garbij ve letaifi-teshrii rrebanij, darul fikr, 1996 Damask-Siri.
15. Han Vahidudin, El mer'etu bejne sheriatil islamijeti ve hadaretil garbijeti, *Femra mes sheriatit islam dhe kulturës perëndimore*/ 1995 Kairo.
16. Ebul eala Elmevdudi, El Hixhab/*Mbulesa*/.
17. Abdurresul abdulhasan el Gafari, El mer'etul muasire/*Femra bashkëkohore*/
18. Dr, Jusuf El Kardavi, fetava muasire/*Fetva bashkëkohore*/.
19. Tahir Had-dadi, imreetuna fish-sheriatil vel muxhtemea/*Femra jonë në shariat dhe shoqëri*, Tunis.
20. Adnan Es-sebij, es-sihatu nefsijeti lil mer'eti vl ummi */shëndeti psiki i femrës dhe nënës*/.
21. Fatime Abdullah, El Moda fi tesavuril Islamij. */Moda nën prizmen islame*/
22. Refik ebu Seud, el i'xhazat hadithe ilmije ve rekamije fil kur'an, */mrekullit e reja shkencore dhe matematikore në Kur'an*/ Darul ma'rife, 1997 Damask-Siri.
23. Ebu Hali Shevki. El Islamu fi kafesil it-tiham, *//Islami në kafesin e akuzuesit*/ darul fikr, bot i pestë 1982, Damask-Siri.
24. Dr Mustaf el Buga, Buhuthun fi nidhamil Islamij, */Hulumtime në sistemin islam*/ 1983, Damask-Siri.
25. Sejid Kutbi. El adalet ixhtimaije fil islam, */Drejtësia shoqërore në Islam*/ daru shuruk, 1987, Kairo.

26. Dr. Sejid Xhemil, el mer'etu fimizanit-tib-bi ved-din,/Femra në peshoren e medicinës dhe fesël/ 1983 Kairo
27. Muhamed Alij el Kutbi, el hub-bu vel xhinsu min mendhuril islamij /Dashuria dhe seksi nën shikimin islam/,
28. Kutbi sejid, fi dhilalil Kur'an
29. Hava Seji-jid, El esasu fit-tefsir,
30. DR. Zuhejli Vehbe, Tefsirul munir
31. Shevki Ebu Halil, tahrirul mer'eti mi-men ve fima hurrij-jetuha,/ emancipimi i femrës nga kush, dhe ku qëndron liria e saj/ darul fikr, 1998, Damask – Siri.
32. Dr. Umare Muhamed, helilislamu huvel hal-lu limadha ve kejfe,/Islami a është zgjidhje, pse, dhe si ?/darush-shuruk, botimi parë 1995, Kairo
33. Fejsal Mevlevij, elmer'etu fil islam,/Femra në Islam/ dar ibni Hazmi 1992-Bejrut-Liban.